

REPUBLICA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVES - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVO
MINISTRIA E BUJQESISE, PYLLTARINE DHE ZHVILLIMIT RURAL
MINISTARSTVO POLJOPRIVREDE, ŠUMARSTVA I RURALNOG RAZVOJA
MINISTRY OF AGRICULTURE, FORESTRY AND RURAL DEVELOPMENT
Arkiv: Qendror - Centralna Arkiva - Central Archive

Nr./Br./No. 68/4
Nr. I fq./Br. Str./No. pg. 3
Data/Datum/Date: 29.01.2024
PRISHTINE - PRISTINA - PRISTINA



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja
Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development

Kabineti i Ministrit / Kabinet Ministra / Cabinet of the Minister

Datë: 29.01.2024
Ref. KM-49/24

Në mbështetje të nenit 145 (paragrafi 2) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke marrë parasysh nenin 2, paragrafi 1 nën paragrafi 1.4, nenet 8, 9, 10, 11 të Ligjit Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/ Nr.7/ 01 mars 2019), bazuar në nenin 44 paragrafi 1 i Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/21 Qershor 2021) dhe nenin 4 paragrafi 1 nën paragrafi 1.11. Shtojcën I pika 11 të Rregullores (QRK)-NR.14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (16.08.2023), Ministri i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, si dhe konform Aktvendimit KE.nr.973/23, i datës 27.12.2023 të Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhomat e Shkallës së Parë, nxjerrë:

VENDIM

1. **VAZHDOHET PROCEDURA** e lirimit të pronës publike P-71914059-02916-22, me sipërfaqe prej 25 ari nga N.T.SH. "PATRONI" Zona Industriale Prishtinë-Fushë Kosovë, Pompa e Derivateve " PATRONI" në pajtim me nenin 2 të Kontratës për Dhënie në Shfrytëzim me Qira të Tokës Bujqësore e datës 01.01.2018, me numër të protokollit 235, konform paralajmërimit të datës 25.10.2023 dhe datës 11.12.2023.
2. Lirimi i pronës do të bëhet me datën 1 shkurt 2024, duke filluar në ora 12,00 h.
3. Lirimi i pronës do të zbatohet ndaj shfrytëzuesit të hapësirës publike N.T.SH. Patroni, me numër të biznesit 80219504, të cilin e përfaqëson drejtori z. Habib Morina.
4. Lënda e lirimit të pronës është lirimi nga njerëzit dhe sendet, nga shfrytëzimi i hapësirës publike P-71914059-02916-22, me sipërfaqe prej 25 ari e cila gjendet në Zonën Industriale Prishtinë – Fushë Kosovës, pronë e Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.
5. Ekzekutimi i Vendimit do të bëhet nga personat dhe organet kompetente të autorizuar të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe me asistimin e Policisë dhe Drejtorisë së Inspektiveve në Komunën e Prishtinës.
6. Gjatë ekzekutimit zyrtarët kompetent do të bëjnë regjistrimin e inventarit – mallit dhe i njëjti do të deponohet në hapësira përkatëse.
7. Pas përfundimit të regjistrimit të investarit të gjetur në hapësirën publike si më lartë,

- zyrtarët kompetent të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, do e bëjnë ndërrimin e cilindrit mbyllës të dyerve të hyrjes dhe do behet mbyllja e tyre.
8. Nëse N.T.SH. Patroni vetë e liron hapësirën publike në fjalë, atëherë organet kompetente do të pezullojnë procedurën e lirimit të pronës.
 9. Shpenzimet e lirimit të pronës publike bien në ngarkesë të N.T.SH. Patroni.
 10. Mjeti juridik i paraqitur kundër këtij Vendimi nuk e ndalon ekzekutimin e tij.

A r s y e t i m

Më datë 01.01.2018 është lidhur Kontrata për Dhënie në Shfrytëzim me Qira të Tokës Bujqësore e datës 01.01.2018, me numër të protokollit 235, për ngastrën kadastrale nr. P-71914059-02916-22, me sipërfaqe prej 25 ari të lidhur në mes të MBPZHR dhe N.T.SH. Patroni. Në bazë të nenit 2 të kësaj kontrate, kohëzgjatja e kontratës ka qenë në kohë të caktuar për pesë (5) vite dhe atë nga data 01.01.2018 deri më datë 31.12.2023. Pra, N.T.SH. Patroni nga data 01.01.2024 është dashur ta liroj pronën në fjalë nga njerëzit dhe sendit për shkak se i ka skaduar kontrata. Për lirimin e kësaj prone brenda afatit N.T.SH. Patroni është njoftuar tri (3) herë, dhe atë përmes shkresës së datës 10.10.2023 nr. 2057/2, shkresës së datës 13.12.2023 nr. 2057/7, dhe shkresës së datës 09.01.2024 nr.68, mirëpo i njëjti nuk ka vepruar konform detyrimeve të tij kontraktuale dhe ligjore dhe nuk i ka marrë parasysh njoftimet-paralajmërimet e dhëna përmes këtyre shkresave. Duke qenë se N.T.SH. Patroni nuk ka vepruar sipas nenit 2, të Kontratës për Dhënie në Shfrytëzim me Qira të Tokës Bujqësore dhe detyrimeve që i ka në bazë të nenit 602, paragrafi 1, të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, MBPZHR më datë 09.01.2024 i ka dërguar N.T.SH. Patroni shkresën me numër nr. 68, paralajmërimi i fundit për mos përmbushje të obligimeve kontraktuale dhe paralajmërim për lirim të pronës, mirëpo N.T.SH. Patroni nuk ka vepruar sipas kësaj shkrese. Pra, MBPZHR që tre (3) herë radhazi kërkon prej N.T.SH. Patroni që ta liroj pronën vullnetarisht konform nenit 2 të kontratës, mirëpo i njëjti nuk e ka bërë një gjë të tillë. N.T.SH. Patroni nuk ka bazë ligjore për ta mbajtur këtë pronë, andaj i njëjti nga data 01.01.2024 e mbanë kundërligjshëm pronën në fjalë.

Lidhur me cështjen e lirimit të kësaj prone, N.T.SH. Patroni ka paraqitur Propozim për Masë të Sigurisë kundër MBPZHR, mirëpo Gjykata Komerciale e Kosovës-Dhomat e Shkallës së Parë me Aktvendimin KE.nr.973/23, i datës 27.12.2023 i kanë refuzuar N.T.SH. Patroni, me të cilën ka kërkuar që t'i ndalohet MBPZHR që të mos ndërmerr asnjë veprim për lirimin e pronës P-71914059-02916-22, me sipërfaqe prej 0,25 h ZK Prishtinë, sipas paralajmërimit të datës 25.10.2023 dhe datës 11.12.2023.

Procedura sipas këtij vendimi është vazhdimësi e procedurës së inicuar sipas paralajmërimit të datës 25.10.2023 dhe datës 11.12.2023 nga MBPZHR, e për të cilën procedurë, Gjykata Komerciale e Kosovës-Dhomat e Shkallës së Parë me Aktvendimin KE.nr.973/23, i datës 27.12.2023, nuk ka konstatuar që ka shkelje ligjore prej MBPZHR me largimin e N.T.SH. Patroni nga prona si më lartë.

Ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, duke u bazuar në nenin 2, paragrafi 1 nën paragrafi 1.4, nenet 8, 9, 10, 11 të Ligjit Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/ Nr.7/ 01 mars 2019), nenin 44 paragrafi 1 i Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/21 Qershor 2021), *citohet*: “*Akti administrativ është çdo manifestim vullneti i një organi publik, që rregullon në mënyrë të njëanshme një marrëdhënie juridike konkrete të së drejtës administrative, me qëllim prodhimin e*

pasojave juridike, dhe: 1.1. u drejtohet një ose disa personave individualisht të përcaktuar (në vijim: administrativ individual”, gjegjësisht “kolektiv”), apo 1.2. i drejtohet një grupi personash, të përcaktuar apo të përcaktueshëm, në bazë të karakteristikave të përgjithshme (në vijim: “akti administrativ i përgjithshëm”), apo 1.3. përcakton statusin sipas të së drejtës administrative të një objekti (sendi) apo të përdorimit të tij nga publiku (në vijim: “akti administrativ in rem”), si dhe duke u bazuar në nenin 2, të Kontratës për Dhënie në Shfrytëzim me Qira të Tokës Bujqësore dhe detyrimeve që i ka në bazë të nenit 602, paragrafi 1, të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Me sa u tha më sipër u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Mjeti juridik nuk e ndal ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë për parashtimin e mjetit juridik, për konflikt administrativ në Gjykatën kompetente për çështje administrative në afat prej 30 ditësh, nga dita e dorëzimit të aktit administrativ përfundimtar palës.

Faton PEÇI
Ministër i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural



Vendimi i dërgohet:

- *N.T.SH. Patroni- përfaqësuar nga Habib Morina,*
- *Ministria e Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike,*
- *Kabinetit të Ministrit,*
- *Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm,*
- *Inspektionit të Komunës së Prishtinës, dhe*
- *Arkivit;*